L I G J
Nr.8228, datë 31.7.1997

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7524, DATË 19.11.1991 "PËR STATUSIN E RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7569, DATE 27.5.1992"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7524, datë 19.11.1991 "Për statusin e Radiotelevizionit Shqiptar", ndryshuar me ligjin nr.7569, datë 27.5.1992" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Këshilli Drejtues i RTSH është organ vendimor. Ai përbëhet nga 21 anëtarë. Në këtë këshill bën pjesë edhe Drejtori I Përgjithshëm i RTSH.

Këshilli Drejtues i RTSH zgjedh nga gjiri i tij kryetarin, i cili drejton veprimtarinë e këtij këshilli.

Zgjedhja e kryetarit bëhet çdo vit me votim të fshehtë ndërmjet dy kandidatëve, që nuk duhet të jenë punonjës të RTSH.

Mbledhja e Këshillit Drejtues të RTSH thirret jo më rrallë se një herë në tre muaj me kërkesën e kryetarit të tij, të drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ose të 1/3 të anëtarëve të tij.

Çdo vit Këshilli Drejtues i RTSH përtërihet deri në 1/3 e anëtarëve.

Neni 2

Në nenin 11, në paragrafin e dytë të hiqen fjalët: "drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues të RTSH dhe...".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më 31.7.1997.

Shpallur me dekretin nr.1864, datë 1.8.1997 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë, Rexhep Meidani